



Republika e Kosovës * Republic of Kosova
Komuna * Municipality
Hani i Elezit



DATE: 18.03.2025

NR.09/ 1937 /2025

KONTRATË PËR SHËRBIME

Numri i kontratës¹: 659-25-694-2-3-6/C614& KKHE-25-002-2-3-6

KOMUNA HANI I ELEZIT (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

Vllaznim Jakupi B.I., N.SH."ALB PRODUCTION"Koshare pn., FERIAJ, 811067588, (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

Transmetimi i drejteperdrejte i seancave te Kuvendit Komunal Hani i Elezit 2025 me numër identifikues: 659-25-694-2-3-6

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit te Shërbimeve:

Transmetimi i seancave te te rregullta te kuvendit komunal dhe seancave te jashtezakonshme sipas nevojës se Kuvendit brenda vitit 2025

No.	Lot
1	Transmetimi i drejteperdrejte i seancave te Kuvendit Komunal Hani i Elezit 2025

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë: **5,820.00 €**; [Pesmijë e tetëqindë e njëzetë Euro/00 cent].

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borbh Ofruesit te Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- Marrëveshja e kontratës;
- Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- Tenderi i Ofruesit te Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);
- [shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

Neni 4

Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënie të ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën Shqipe² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Xhevdet Bushi
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	18.03.2025
Vula:	

Për Ofruesin e Shërbimeve Vllaznim Jakupi B.I.

Emri:	Vllaznim Jakupi
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	18.03.2025
Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 659-25-694-2-3-6/C614: KKHE-25-002-2-3-6

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Shqipe.
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është [18.03.2025].
	6.4	Data e Përfundimit është [17.03.2026].
	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve është Kuvendi komunal i Komunes Hani i Elezit për transmetimi te seancave dhe transmetime tjera ne ambientet e tjera te Komunes
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit do te cakohet me vendim te veqantë të ZKA-së.
Dëmet e likuiduara	13.1	Norma e dëmeve të likuiduara është 0.25%] në ditë për shërbime të parealizuar Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është 10% të çmimit final të kontratës
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është: 10% e vlerës së kontratës me afat prej 13 muajve.
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve	15.1	
Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	Orari i pagesës do të jetë: Pas realizimit të shërbimit –transmetimi i seancave te kuvendit dhe transmetime tjera te per nevoja te komunes
Kontrolli i kualitetit	17.1	Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në vijim: AK-respektivisht menaxheri i kontratës do te kontrollojnë cilësinë dhe sasinë e realizimit të shërbimit. <i>Transmetimi i drejtperdrejtë do te llogaritet vetem per punim te kuvendit, kurse incizimet tjera mund te transmetohen ne nje kohe me te pershtatshme ne kordinim me AK-në</i> <i>Vlen per t'u theksuar se pauzat nuk hyn apo nuk do te llogariten si minutazh transmetimi.</i> <i>Koha e transmetimit llogaritet koha e fillimit deri ne pauze, ashtu siq caktohet koha nga kryesuesi i kuvendit, Pra perjashtohen pregatitjet (montimi i teknikes, dhe pregatitjet tjera perciellëse)</i> Periudha Garantuese e Defekteve është [shëno datën]
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	[Specifikoni departamentin e Komisionit përgjegjës për pajtim]
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjykata komerciale në Prishtinë] në pajtim me ligjin në Kosovë. b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].